



01/Nr.4296/2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr. 03L/l-048 neni 20, Ligji mbi Financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L-49 neni 2, Qarkorja Buxhetore 2018/01 për Komunitat e datës 15.05.2017, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 75, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 22.06.2017 merr:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE TË KOMUNËS SË HANIT
TË ELEZIT PËR VITET 2018-2020

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2018-2020 e cila përmban planifikimet buxhetore nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake. Buxheti për vitin 2018 është në lartësi prej **2,716,597 €**, ndërsa projeksionet për vitin 2019 janë në shumë prej **2,907,498 €** dhe për vitin 2020 janë në lartësi prej **2,727,750 €**.

II

Në strukturën e të hyrave të tërësishme buxhetore për vitin 2018 sipas pikës I të këtij vendimi, mjetet nga grantet qeveritare janë në shumë prej 2,413,000 €, që shënojnë pjesëmarrje në shumë prej 88.82%, ndërsa nga të hyrat vetanake komunale në shumë prej 303,597 € apo 11.18%.

III

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin 2018 sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve parashikohen të kenë këto ndarje: Paga dhe mëditje 1,445,946 €, Mallra dhe shërbime 227,713 €, Shpenzime Komunale 49,800 €, Subvencione dhe transfere 60,000 € dhe Shpenzime kapitale 933,138 €.

IV

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

V

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Financave – Departamenti i Buxhetit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 22. 06. 2017



Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Braya